



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KE.nr.124/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike të paditësit NSH IMN “KOSOVA” me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokati Basri Jupolli, nga Prishtina, kundër të paditurit Komuna e Prishtinës, me objekt kontesti kompensimi i dëmit për shkak të eksproprijimit, jashtë seancës, me datën 30.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet JO KOMPETENTE, për të vendosur sipas padisë së paditësit NSH IMN “KOSOVA” me numër të lëndës KE.nr.124/22 (2019:212961), të datës 31.12.2012, kundër të paditurit Komuna e Prishtinës, me objekt kontesti kompensimi i dëmit për shkak të eksproprijimit.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm.

A r s y e t i m

Paditësi NSH IMN “KOSOVA” përmes të autorizuarit të tij me datë 31.12.2012, ka paraqitur padi pranë Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, kundër të paditurit Komuna e Prishtinës, me të cilën ka kërkuar shpërblimin e paluajtshmërisë, në të cilën është ndërtuar rruga publike.

Gjykata gjatë shqyrtimit të padisë dhe shkresave të lëndës në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së, vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës në këtë çështje juridike dhe gjeti se Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje.

Gjykata duke u bazuar në nenin 13 par. 1.1 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, me të cilin përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*.

Meqenëse në rastin konkret objekt shqyrtimi sipas padisë së paraqitur është shpërblimi i paluajtshmërisë mbi bazën e shpronësimit, në të cilën është ndërtuar rruga publike, rrjedhë se kërkesa është paraqitur për kompensimin e pronës së shpronësuar/ekspropriuar dhe meqenëse Departamenti për Çështje Ekonomike në kuadër të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale të Kosovës, është kompetent për të vendosur kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre, rezulton se kjo çështje nuk bie në kompetencë lëndore të kësaj gjykate dhe duke u bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr. 06/L-054), kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 lidhur me nenin 387.1 pika (u) dhe nenin 392 pika. (b) të LPK-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.124/22, datë 30.05.2024.

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.